

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“Weflo Albania” shpk.

Në Tiranë, sot më datë 09.03.2020, ne të poshtëshënuarit:

- 1- Rosario D’Andrea, i datëlindjes 27.06.1974, djali i Salvatore, lindur në Napoli (Itali) dhe banues në Irlandë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte, me numër YA 4565657.
- 2- James Christopher Ormond, i datëlindjes 05.08.1987, djali i Damien, lindur dhe banues në Irlandë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte , me numër PD0967646.

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Weflo Albania” shpk.**

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“Weflo Albania” shpk.** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Njesia Bashkiake nr.5, blloku “Vasil Shanto”, rruga “Viktor Eftimiu”, pallati “Helio Konstruksion”, kati toke.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Import dhe eksport te materialeve hidraulike, pajisjeve te ajrit te kondicionuar, paneleve diellore, pjeseve te kembimi per materialet hidraulike dhe te kesaj natyre, shitje online e produkteve te paneleve diellore, te pajisjeve te ajrit te kondicionuar dhe materialeve hidraulike.



Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100 lekë, i ndarë në dy kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

1. Rosario D'Andrea, zotëron 1 kuotë me vlerë 51 lekë, e cila përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë
2. James Christopher Ormond, zotëron 1 kuotë me vlerë 49 lekë, e cila përbën 49% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;



- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

- 1- Rosario D'Andrea, i datëlindjes 27.06.1974, djali i Salvatore, lindur në Napoli (Itali) dhe banues në Irlandë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte, me numër YA 4565657, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nën nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare “Weflo Albania” shpk., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale.

ORTAKËT THEMELUES

Rosario D'Andrea

James Christopher Ormond